



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 760/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Flamur Istrefi nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.760/2021 i datës 03.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Flamur Istrefi nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar që ta përfshihet në listën përfundimtare si anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 në ora 17:41, nga Flamur Istrefi kandidat për Kuvendin Komunal në Ferizaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i cili thekson se nga shpallja e rezultateve nga KQZ-ja subjekti politik LDK ka fituar gjithsej 4 vende për Kuvendin Komunal në Ferizaj, ku nga kjo liste i njëjti pretendon se është renditur i 4-ti, për nga numri i votave të marra me gjithsej 231 vota, ndërsa KQZ-ja ka shpallur fituese kandidaten Jehona Mustafa Krasniqi me më pak vota nga Lista e LDK-se e cila renditet për nga numri i votave të marra me gjithsej 217 vota apo 14 vota më pak se parashtruesi i apelit. Parashtruesi i apelit thekson se KQZ-ja duke dashur ta respektojë kuotën gjinore prej 30% ka bërë diskriminim ndaj tij duke mohuar të drejtën që të jete në listën fituese ngase kuota prej 30% është tejkaluar me votat të cilat i ka marrë gjinia e nën përfaqësuar, ku përbërja e Kuvendit komunal në Ferizaj me rezultatet e shpallura tejkalon kuotën prej 30%. I njëjti thekson se kuota gjinore është dashur të merret parasysh në kuadër të përbërjes si tersi të Kuvendit Komunal në Ferizaj, pasi që në këtë rast kemi diskriminim edhe brenda subjektit sa i përket kuotës 30% ngase KQZ-ja ka gabuar edhe në llogaritjen e përqindjes brenda subjektit ngase nga 4 delegate sa i ka fituar LDK-ja ku 30% i katër(4) delegateve i bie 1.2 që nënkupton se LDK në Kuvendin Komunal në Ferizaj në baze të votave të fituara nga kandidatet e saj duhet të përfaqësohet nga tre (3) meshkuj dhe një (1) femër e jo 2 meshkuj e 2 femra.

Parashtruesi i apelit thekson se KQZ-ja nuk ka marre për baze as vendimin e Gjykatës Kushtetuese e cila e sqaron sakte renditjen e përfundimtare dhe zëvendësimet sa i përket kuotës prej 30%, andaj kërkon nga PZAP-i që ta korrigjoj këtë padrejtësi nga ana e KQZ-se dhe ta vendos në listën fituese në baze të provave të fituara.

Në përgjigjen e saj KQZ thekson se sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, paragrafit 4, në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës më të votuar).

Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së ankuesit, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nënpërfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon:

“8.3 Vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësishtë zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

8.4 Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.”

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet rastet KI45/20 dhe KI46/20, e cila mes tjerash përcakton:

“131. [...] Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimin të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues.

Vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese në frymën e aktgjykimit të saj ka trajtuar vetëm kuotat gjinore që aplikohen brenda listave të kandidatëve të atij subjekti politik, e jo të institucioneve relevante në tërësi.

Prandaj pretendimet e palës ankuese janë të pabazuar dhe në shpërputhje me nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është katër (4) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë dy (2), pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra. Si deshmë kësaj përgjigje i kanë bashkangjitur formulën me numrin më të vogël të kandidatëve nga gjinia e kundërt.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, ju është mohuar e drejta që të jetë anëtar për Kuvendin Komunal në Ferizaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara sepse në nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për shpërndarjen e vendeve për anetarë të Kuvendeve Komunale si dhe në Rregullën Zgjedhore të KQZ-së nr 08/2013 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre është e percaktuar formula për ndarjen e ulëseve, ku nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është katër (4) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë dy (2), pra duhet të jen dy meshkuj dhe dy femra. Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit (KQZ), 2948/2021 të datës 03.11.2021 drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8.3 dhe 8.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për shpërndarjen e vendeve për anetarë të Kuvendeve Komunale si dhe Rregullën Zgjedhore të KQZ-së nr 08/2013.

Pretendimet e parashtruesit të apelit i cili thekson se KQZ-ja nuk ka marrë për baze as vendimin e Gjykatës Kushtetuese e cila e sqaron sakte renditjen e përfundimtare dhe zëvendësimet sa i përket kuotës prej 30%, Paneli thekson se Gjykata Kushtetuese në frymën e aktgjykimit të saj ka trajtuar vetëm kuotat gjinore që aplikohen brenda listave të kandidatëve të atij subjekti politik.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe mbi këtë bazë i njëjti nuk i plotëson kriteret e sipërcituara për tu emëruar si anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, dhe mbi këtë bazë si dhe në pajtim me nenin 115.1, nenin 117.3 e lidhur më nenin 118.1, të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.760/2021 më datën 05.11.2021

Kryesuesi i Panelit

Ferki Xhaferi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.

